



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 451/1 Prot.

Tiranë, më 14.04.2025

V E N D I M

Nr. 82, Datë 14.04.2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,² mori në shqyrtim ankesën nr. 60, datë 7.3.2025, të paraqitur nga organizata jofitimpruresë Qendra “Qendresa Qytetare” kundër Këshillit të Ministrave, me pretendimin për diskriminim për shkak të *gjendjes arsimore*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron:

Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr.425, datë 26.6.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të Sistemit Arsimor Parauniversitar”, i cili ka ndryshuar strukturën dhe nivelet e pagave të punonjësve mësimorë dhe jomësimorë të sistemit parauniversitar. Ky vendim ka sjellë pasoja negative për mësuesit e arsimit fillor, veçanërisht për ata që janë diplomuar në ish-institutet e rretheve, pasi nuk u njihet diploma si studim i plotë për mësuesi, por vetëm si cikli i parë Bachelor. Krahësuar me Vendimin nr.175, datë 18.3.2017, ndryshimet e reja kanë sjellë rritje të diferencuar për një kategori të caktuar mësuesish për shkak të mosnjohjes së kualifikimeve të tyre në të njëjtën mënyrë si më parë. Kjo situatë ka krijuar një trajtim të pabarabartë financiar mes grupeve të ndryshme të mësuesve me të njëjtën përvojë dhe të njëjtin nivel arsimor të përfituar sipas kushteve të kohës, ku mësuesit e dalë kryesisht në vitet 1992-1998 në institutet e rretheve i njëjti cikli 3 vjeçar, si cikël i plotë i studimeve për kategorinë mësues, duke mos patur asnjë detyrim tjetër akademik.

Vendimi nr.425/2024 ka krijuar një diferencim të padrejtë në trajtimin financiar të mësuesve të arsimit parashkollor. Ligji nr.69/2012 për arsimin parauniversitar përcakton qartë se qeveria duhet të respektojë barazinë mes grupeve të punonjësve me të njëjtat përgjegjësi. Megjithatë, vendimi i

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

ri vendos kritere të reja për vlerësimin e diplomave pa marrë në konsideratë kontekstin e kohës kur këto diploma janë marrë. Kjo bie në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, duke iu ndryshuar mësuesve, të drejtat e tyre të fituara tashmë. Mësuesit me të njëjtën përvojë dhe detyra trajtohen ndryshe bazuar në një ndryshim retrospektiv të interpretimit të diplomave të tyre, duke shkaktuar një efekt negativ në të ardhurat e tyre mujore. Për më tepër, Këshilli i Ministrave, kërkon nga mësuesit e arsimit parashkollor që për efekt të rritjes financiare të ndjekin cikle shtesë studimi, ndërkohë që, në asnjë institucion të arsimit të lartë ky cikël nuk ofrohet për të njëjtin program.

Gjithashtu, vendimi nuk siguron një rrugë të qartë për mësuesit që duhet të përmbushin kriteret e reja të kualifikimit. Në mungesë të një programi konkret të përshtatur për këtë kategori, mësuesit mbeten pa zgjidhje të qartë për të rritur nivelin e tyre akademik në përputhje me kërkesat e reja. Kjo situatë i vë ata në një pozitë të pabarabartë dhe pengon zhvillimin e tyre profesional, duke i penalizuar financiarisht.

Përveç pasojave ligjore, vendimi ka një ndikim të drejtëpërdrejtë negativ në jetën sociale dhe ekonomike të mësuesve të prekur. Diferencimi financiar prek standardin e jetesës së një numri të madh mësuesish, të cilët për vite kanë kontribuar në edukimin e brezave të rinj. Kjo jo vetëm që krijon vështirësi ekonomike, por edhe demotivon mësuesit, duke ndikuar negativisht në cilësinë e mësimdhënies. Një mësues i demotivuar nuk mund të përmbushë me të njëjtin efektivitet detyrat e tij profesionale, çka mund të reflektohet në cilësinë e arsimit që marrin nxënësit.

Pala ankuese kërkon nga Komisioneri marrjen masave ligjore për të shmangur pasoja negative të këtij vendimi dhe rishikimin e kriterëve nga ana e Këshillit të Ministrave në mënyrë që të garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë mësuesit dhe edukatorët e prekur.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “b”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cënohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: *“Organizatata me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar*

të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”.

Nga aktet e administruara rezulton se, Qendra “Qendresa Qytetare” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 1120, datë 15.9.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Qendra “Qendresa Qytetare” nuk pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon se Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.425, datë 26.6.2024 *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të Sistemit Arsimor Parauniversitar”*, diskriminon për shkak të gjendjes arsimore mësuesit të cilët janë diplomuar në ish-institutet e rretheve, pasi nuk iu njihet diploma si studim i plotë për mësuesi por vetëm si cikli i parë Bachelor . Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Qendra “Qendresa Qytetare”, është një organizatë jofitimprurëse e cila ka si qëllim mbrojtjen e dinjitetit dhe personalitetit njerëzor dhe forcimin e qytetarisë, ndër të tjera nëpërmjet orientimit drejt një arsimi cilësor. Disa nga objektivat e organizatës janë rritja e ndërgjegjes kombëtare dhe promovimi i një sistemi arsimor cilësor dhe mbrojtja nga diskriminimi dhe dhuna në institucionet publike dhe familje.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së palës ankuese dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Sipas nenit 32, pika 3 të LMD, përcaktohet se, për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.

Kodi i Procedurave Administrative rregullon zotësinë për të vepruar, në një procedurë administrative, në nenin 34. Sipas pikës 2 të kësaj dispozite, përcakohet se, në ratet kur pala në një procedurë administrative nuk është një organ publik, zotësia për të vepruar, në një procedurë administrative, e personave të tjerë rregullohet sipas legjislacionit në fuqi.

Sipas nenit 31 të Kodit Civil, përcaktohet: *“Personi juridik vepron me anë të organeve të veta të parashikuara në ligj, në aktin e krijimit ose në statut, të cilët shprehin vullnetin e tij. Veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brenda kompetencave të tyre, quhen si të kryera nga vetë personi juridik.”*

Pala ankuese Qendra “Qendresa Qytetare” është një person juridik në formën e një oragnizate jofitimprurëse. Organet e saj vendimarrëse dhe drejtuese janë përcaktuar në aktin e saj të themelimit dhe statutin. Referuar akteve të funksionimit të palës ankuese, rezulton se të drejtën e përfaqësimit të organizatës e ka Drejtori Ekzekutiv. Nga aktet e administruara rezulton se, ankesa objekt shqyrtimi e paraqitur nga pala është nënshkruar nga z. R. Xh, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës “Qendresa Qytetare”.

Në bazë të vendimit nr.1120/2, datë 31.1.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se z. R.Xh është zgjedhur si Drejtor Ekzekutiv i Qendrës “Qendresa Qytetare” me mandate për periudhën 2022-2024, ndërsa ankesa është depozituar pranë Komisionerit më datë 7.3.2025.

Komisioneri vlerëson se, në momentin e depozitimit të ankesës z. R.Xh, nuk ka patur të drejtën të përfaqësojë palën ankuese Qendra “Qendresa Qytetare” në marrëdhënie me të tretët dhe rrjedhimisht në paraqesë dhe të nënshkruajë në emër të saj ankesën objekt shqyrtimi, pasi mandati i tij si Drejtor Ekzekutiv ka përfunduar në vitin 2024, ndërsa nuk rezulton nga aktet e administruara që të jetë rizgjedhur në këtë pozicion.

Nëpërmjet *e-mailit* të datës 12.3.2025 dhe 20.3.2025, Komisioneri i komunikoi palës ankuese të metat e konstatuara në lidhje me legjitimitimin e përfaqësuesit, por këto të meta nuk u plotësuan.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;” Komisioneri vlerëson se ankesa nr.20, datë 7.3.2025, e paraqitur nga pala ankuese Qendra “Qendresa Qytetare” nuk mund të pranohet, pasi nuk përmbush kriteret ligjore dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 60 regj., datë 7.3.2025, të paraqitur nga Qendra “Qendresa Qytetare”, pasi nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja arsimore
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim